



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 38

Datë: 08. 07. 2017, ora: 12:30

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Nenad Rikallo, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Krye shef i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC. Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;**
- 2. Certifikimin i Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Kosovës të 11 Qershorit 2017;**
- 3. Raport i Këshillave të KQZ-së;**
 - **Këshilli për Operacione Zgjedhore;**
 - Këshilli për Buxhet dhe Financa;**
 - *Shqyrtimi dhe miratimi i rishikimit të Buxhetit të KQZ-së për vitin 2017;*
 - *Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Planit të Buxhetit të KQZ-së për vitin 2018-2020;*
 - *Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për mbushjet shtesë të telefonisë mobile, për Zgjedhjet Lokale 2017;*
 - **Këshilli për Personel**
 - *Shqyrtimi dhe miratimi i angazhimit të stafit jo permanent për zgjedhjet lokale 2017;*

4. Shqyrtim i dhe miratimi i draft vendimit për caktimin e lartesisë së mjeteve nga Fondi për Mbështetjen e subjekteve politike për vitin 2017;

5. Të ndryshme;

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Valdete Daka: Nga paneli zgjedhorë, kemi marrë shkresën se nuk ka ankesa, nga Gjykata supreme po ashtu kemi marrë shkresën se nuk ka më ankesa, dhe se janë të vendosur të gjitha. Nga Vebi Imeri, kemi marrë shkresën ku ai ka hequr dorë nga ankesa e tij, nga e drejta e tij për ankim dhe po ashtu, kemi marrë rezultatet nga QNR-ja...! kemi marrë shkresat edhe nga ata që është dashur me vendosë në mes të dy pozitave, dhe ligjerishtë, ne nuk e kemi asnjë pengesë për çertifikim të rezultatëve. Teksti, është në rregull, cilën nuk ka nevojë për as një konfirmim tjetër...A i çertifikojmë, a jemi të gjithë...?

Adnan Rrustemi: Është mirë m'u deklaruar secili veç e veç...

Sami Hamitj: Unë nuk jamë për...!

Betim Gjoshi: Kryetare, te çertifikimi është i mirë se nuk na vënë votat e kualifikuarë se, është e vertetë se çka deklaroi Eshrefi...Unë, e kam ngritur prej dje se, në 3 orë përfundon afati zyrtarë i drejtës së ankesës së Vebiut, zyrtarisht dhe ligjërishit ju ka drejtu institucioneve të drejtës së tërheqjes së ankesës. Kjo, është procedur administrative mbi të gjitha, kemi marrë konfirmimin e institucioneve legjistrative nuk ka procedur dhe zgjidhje të ankesave. Me këto d.m.th, neve na u ka hapur rruga, me i çertifiku...

Valdete Daka: Të tjerët nuk kanë të drejtë, anekese ata munden me u anku por nuk është e lejuar, atëhere a do ti çertifikojmë këto apo ato atje. Mirë, kush është për çertifikim e këtyre rezultateve?

Anëtarët e KQZ-së, me vota unanime certifikuan rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura më 11 qershorit 2017.

2. Raport i Këshillave të KQZ-së:

- **Këshilli për Operacione Zgjedhore:**

Adnan Rrustemi: Këshilli për Operacione Zgjedhore, ka rishqyrtuar dy kërkesa po i quaj nga Sekretariati për katër aktivitete që janë planifikuar në planin e punës së këtij viti të cilat, për arsye të proceseve zgjedhore, disa janë ndërprerë në realizim e sipër, e disa të tjera s'kan filluar ende...! Dhe kanë rekomandu me i miratuar për me i bartë në planin e punës për vitin e ardhshëm... Kjo, ka një implikim që ata kanë një nevojë për me e planifiku bugjetin për me ditë paraprakishtë. Apo, i miratojmë mbasi për

me i bartë...Si KOZ, e kemi bërë raportin e rekomandimit për KQZ-në që t'i miratojë, që t'i bartë për vitin e ardhshëm. Bëhet fjalë për projektin e Listës Votuese, për me e përmisuar listen...një aktivitet që është një projekt që mbështet nga IFESI në realizim e sipër, dy aktivitet të teknologjisë informative për disa sisteme ...Të tjerat janë për votim jashtë vendit për regjistrim...Në ndërkohë, ne do t'i kemi edhe projektet e veçanta për vitin e ardhshëm...

Betim Gjoshi: Unë, gjithsesi nuk po kam dëshirë me ia humbur vlerën çertifikimit të rezultatëve zgjedhore...Nuk ndonjë problem për me i shty këto projekte, por ne mos të harrojmë se plani i punës nuk ka përfunduar për mos realizimin e këtyre projektëve...Plani i punës i krejt këtyre pikave, e vërteton te auditori që janë ma të ndishmë për institucionin...Dhe, nuk është plotësuar...Ne, ende i kemi pozitat e lira, i kemi shpenzu me mijëra euro për rregulloret e punës dhe, duhet me marrë përgjegjësinë... Plani i punës, është dashur me u rishikuar edhe nga aspekti i realizimit...Unë, shpresoj që nga kjo mbledhje, të fillojë të realizohet plani i punës: nëse jo nga aspekti kohorë, nga aspekti i sasisë...Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimet e KOZ-it.

3. Këshilli për Buxhet dhe Financa:

1.Shqyrtimi dhe miratimi i rishikimit të Buxhetit të KQZ-së për vitin 2017

Ilir Gashi: Këshilli, dje ka mbajtur mbledhje të radhës, dhe ka trajtuar tre pika të rendit të ditës të cilat, i keni para vetit po fillojmë në pikën e parë: Shqyrtimin dhe Miratimin e Bugjetit të KQZ-së për vitin 2017. Ju, tha z. Gashi, siq e dini për ligjet për miratimin e financave publike si dhe instruksionet për kemi bugjet për vitin 2017 nga komisioni i zgjedhjeve, përgaditet për rishikimin e bugjetit...Kryesisht, kemi mbajtur mbledhjen dhe për të plotësuar buxhetin për zgjedhjet lokale të cilat, zakonisht për shkak të ndarjes që kemi mbajtur, dhe qeveria ka ndarë një buxhetë për zgjedhjet e jashtë zakonshëm por, në të njejtën kohë edhe e ka bërë në bugjetin e ndarë edhe për ato zgjedhje dhe është marrë një afro edhe 2 milionë Euro. Nga bugjeti, i kemi marrë për zgjedhjet lokale të parapara si bugjet i miratuarë kështu që ne e kemi trajtuar bazë edhe të kërkesave që kanë ardh edhe nga njësit kërkuar kemi miratuar këtë ndryshim. Për kërkesë për plotësim të bugjetit nga ana e qeverisë, dhe bugjetin e keni para vetit...Ta miratojmë dhe t'ia dërgojmë qeverisë...

Betim Gjoshi: Ky është buxhetit për vitin 2017, dhe unë nuk jam duke e kuptuar qartë...! Unë, mundova që po e miratojmë një buxhet për zgjedhjet Lokale, se ligji e kërkon që të miratohet një buxhet për zgjedhjet lokale se, ne një pjesë tjetër të buxhetit e kemi në bazë të saj që ne ta bëjmë një kërkesë për sa kemi mjete mangut...

Ilir Gashi: Buxheti për zgjedhje lokale është i miratuar si total prej 11 milion 618 mijë euro në fillim, mirëpo buxhetin të miratuar ministria na ka marrur.... E ka dërguar për fond të veçant për zgjedhje të jashtëzakonshme dhe, ne vetëm shtesën prej 1 milion e 900 mijë eurove kemi kërkuar me na plotësuar

si e kanë nda pjesën për zgjedhjet e përgjithshme ka thënë që po ju marrim, por që do t'ua rikthejmë buxhetin që e keni të miratuar për zgjedhje lokale...

Betim Gjoshi: Po mendoj që ne kemi mundur të kursejmë ose të shpenzojmë më shumë në këtë periudhën, ndoshta kërkesa për Qeverinë ka mundur me qenë më e madhe ose më e vogël, në këtë aspekt d.m.th. unë e ngrita si çështje që, ndoshta kishte qenë mirë një tekst më i lehtë atyre që ju drejtohemi... Se po përmendet është e vërtet ne faqen 7 unë e lexova si dokument por, nuk ka lidhje.

Ilir Gashi: Faktikisht ne e kemi trajtuar në këshill por, nuk ka qenë e lehtë sepse akoma shumë pagesa janë pa u kry. Nuk ka qenë e lehtë me ditë saktë sa mbesin edhe sa janë. Kështu që jemi pajtuar edhe me propozimin me atë analizë që e ka bërë Sekretariati që kjo të shkoj kështu...

Valdete Daka: Faleminderit. Atëherë, kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së miratuan rishikimin e Buxhetit të KQZ-së për vitin 2017

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Planit të Buxhetit të KQZ-së për vitin 2018-2020

Ilir Gashi: Natyrisht edhe këtë e keni para vetit, besoj që e keni lexuar, këto janë kërkesat e dalura nga të gjitha njësitë kërkuese dhe planifikimi i buxhetit është ky për vitin 2018-2020.

Adnan Rrustemi: E kam fjalën te buxheti për 3 vitet e ardhshme për subjektet politike, po bëhet një farë padrejtësie se gjithmonë po mbet shumë më fikse e unë mendoj se ajo ndryshon edhe me ligj.

Anëtarët e KQZ –së miratuan *Draft Planin e Buxhetit të KQZ-së për vitin 2018-2020*

3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për mbushjet shtesë të telefonisë mobile, për Zgjedhjet Lokale 2017

Ilir Gashi: Është edhe një çështje tjetër lidhur me mbushjet elektronike - telefonike për zgjedhjet lokale, dhe ndonëse nuk ka material, ne kemi menduar që kjo të aprovohet si edhe në zgjedhjet e kaluara.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan kërkesën për mbushjet telefonike.

4. Këshilli për Personel

Shqyrtimi dhe miratimi i angazhimit të stafit jo permanent për zgjedhjet lokale 2017

Bajram Ljatifi: Ne, kemi mbajtur mbledhjen e këshillit, dhe kemi vendosur që stafit jo permanent që ka marrë pjesë në zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kuvend, t'ua vazhdojmë mandatin edhe për zgjedhjet Lokale. Ne, kemi tri propozime lidhur me kategoritë e caktuara, pra duke u mbështetur në performancat e tyre pa ndonjë procedurë tjetër...Prandaj, këshilli i rekomandon KQZ –së që, ta miratojë vendimin e këshillit...

Betim Gjoshi: Nëse më lejohej kam dy çështje: Unë po besoj që sekretariati i ka menduar për ndonjë aktivitet. Besoj që QNR që nuk ka, është mirë me i lëshuar në pushim. E dyta, ne edhe herën e kaluar kemi marrë vendim që me i thirrë të njëjtin staf që kanë qenë në zgjedhjet e fundit, por e kemi parë që ka ndryshuar. Është mirë me mbajt një data bazë të këtyre personave, sidomos të atyre që punojnë mirë...

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimin lidhur me stafin jo permanent

Valdete Daka: Shqyrtimi dhe miratimi i draftvendimit. Këtu, vetëm një pyetje. Qysh po e miratojmë ne këtë ata ende nuk janë në kuvend?! Në bazë të rezultateve? Kush është për? Në dy baza i keni borxhet. A e vazhdojmë mbledhjen pasi të shkojmë lartë. E kemi edhe për Bukuresht. Për punëtori. Kam biseduar me Bujarin, ai më ka thënë bëje një projekt të hënën dhe një shkresë me ma drejtuar unë i përfundoj punët tjera. Dy javë pas të hënës. Këto janë datat.

Enis Halimi: Kryetare, vetëm sa për informatë. Koncepti ashtu si kemi biseduar i projektit për këtë punëtori është i gatshëm. Të hënën presim ta nënshkruajmë dhe ta procedojmë...

Betim Gjoshi: Sa persona, kryetare?

Valdete Daka: Kjo është me rëndësi. Anëtarët, dhe duhet me biseduar edhe me OSBE-në, sa janë ata të gatshëm me i mbuluar. Edhe vendi ku? Ne ku të dojmë, pasi ata kështu na kanë thënë? Në Tiranë? A jemi të gjithë për Tiranë? Në rregull. Të gjithë për Tiranë. 26 persona në Tiranë. U kry hajde ? E tash sa ditë nuk e di , sa të thojnë ata ? 3 ditë 3 netë , 4 ditë kështu ? Në Budapest jo në Bukuresht është asambleja gjenerale e AVEB e kemi ftësën , dy zyrtarë tonë mendoj dy anëtar paguhen nga ata ndërkaq nëse dojna shtesë me i pagu na. Për me qenë korrekt kemi thanë atëherë Valmiri do të shkon sepse kemi thanë me përcjell punën e asamblesë edhe punën tonë.

Valdete Daka- Adnani, Betimi,unë dhe Valmiri. Kush është për...?

Për KQZ

Valdete Daka, kryetare
